



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR LIRIMIN E ANËTARES TË KZAZ NR. 32, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 23.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Lirimin e anëtares të KZAZ nr. 32, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 32, pika 2, neni 63, pika 4, germa "ë", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin Nr. 114, datë 02.04.2019, ka emëruar anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

Me shkresën nr. 4173 prot., datë 22.05.2019, bazuar në nenin 63, pika 4, germa "ë", të Kodit Zgjedhor, znj. Liri Jani, ka kërkuar lirim nga detyra e anëtares të KZAZ nr. 32, Bashkia Tiranë.

Kërkesa e paraqitur nga znj. Liri Jani, është në përputhje me kërkesat e nenit 63, pika 4, gërma "ë", të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 32, pika 2, nenin 63, pika 4, gërma "ë", të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,



V E N D O S I:

1. Të lirojë nga detyra anëtares e KZAZ nr. 32, sipas kërkesës së znj. Liri Jani, anëtare e KZAZ nr. 32, Bashkia Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

